

UDHËZIM
Nr.42, datë 12.10.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E DOKUMENTACIONIT
TË SUBJEKTEVE APLIKUESE PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT PËR
ORGANIZIMIN E LOJËRAVE PROMOCIONALE TË FATIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 të nenit 10 të ligjit nr.10033, datë 11.12.2008, si dhe pikës 15 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.770, datë 15.7.2009 “Për mënyrën, formën, kriteret dhe rregullat shtesë për organizimin e lojërave promociionale të fatit”, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Për marrjen e autorizimit për organizimin e lojërave promociionale të fatit, subjekti aplikues duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm pranë Ministrisë së Financave, drejtuar Njësisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

2. NJMLF-ja verifikon menjëherë përputhjen e dokumentacionit me kërkesat e pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.770, datë 15.7.2009.

3. Drejtori i NJMLF-së i përcjell Ministrit të Financave, brenda 2 javëve nga data e dorëzimit të kërkesës, autorizimin përkatës, së bashku me dokumentacionin shoqërues dhe argumentimin për miratimin ose jo të autorizimit, ose argumenton se aplikimi përkatës nuk përfshihet në kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave dhe nuk është e nevojshme pajisja me autorizim.

4. Ministri i Financave në vijim të procedurës së mësipërme, miraton ose jo, brenda 20 ditëve punë nga paraqitja e kërkesës në protokollin e Ministrisë së Financave, autorizimin përkatës ose e refuzon atë duke argumentuar refuzimin.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode